



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1580 /₄ Prot

Tiranë, më 06/12 /2013

REKOMANDIM

Nr. 48 datë 06/12 /2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "**Qendra Kombëtare e Licencimit**", Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 229 datë 07.11.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "**Qendra Kombëtare e Licencimit**", me adresë, Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati III, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Respektimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale (nenet 12-17 të ligjit);
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtja e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesi i kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi "**Qendra Kombëtare e Licencimit**" (institucion publik) kryen aktivitetin si një qendër me një ndalesë (one-stop-shop) për aplikimin dhe dhënien e licencave, autorizimeve e lejeve në fusha të ndryshme, në zbatim të Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009

“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë aplikantë (ose kërkues) dhe punonjës. Për kategorinë “aplikant” (kërkues) gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale si: *emri, mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, numri i kartës së identitetit, adresa, karakteristika banesash ose objektesh*.

Të dhënat mblidhen nga personeli i sporteve, ku bëhet aplikimi për licencë, leje ose autorizim. Këto të dhëna bëhen publike në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, i cili është një portal i integruar të dhënash elektronike. Në regjistrin publikohen titujt e licencave (neni 23 i ligjit të sipërpërmendur) të cilat ndër të tjera përmbajnë edhe të dhënat për identifikimin e titullarit (person fizik ose juridik).

Për kategorinë “punonjës” kontrolluesi mbledh të dhëna personale si; *emri, mbiemri, data e lindjes, vendlindja, numrin e librezës së punës, gjendja civile, arsimit, raport mjekësor, kualifikime*. Këto të dhëna administrohen në “Dosjen personale të punonjësit”, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Të dhënat personale të aplikantëve (kërkuesve) dhe punonjësve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen (të parashikuara në ligj). Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për aplikantët është vetëm ofrimi i shërbimeve publike nga QKL. Ndërsa qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për punonjësit lidhet me mbarëvajtjen e punës në kuadër të zbatimit të legjislacionit përkatës në këtë fushë.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi në faqen zyrtare në internet nuk ka të publikuar “politikat e privatësisë”, që janë një paketë rregullash të cilat kanë si qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen (të cilët mund të jenë edhe aplikantë ose titullar licence) mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (aplikantë ose titullar licence) dhe detyrimet e kontrolluesit (QKL-së). Këto politika ndikojnë në sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Sa i përket pikës së parë të objektit të kontrollit lidhur me respektimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave (nenet 5-9 dhe 12-16), Komisioneri konstaton se:

- 1) Kontrolluesi përpunon vetëm të dhënat personale që përbëjnë objektin e veprimtarisë së tij bazuar në ligj, duke respektuar në këtë mënyrë parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave (shkronja c) e pikës 1 të nenit 5).
- 2) Të dhënat personale të aplikantëve mbahen për një afat të pacaktuar për arsye se dhe titujt e licencave janë me afat të pacaktuar. Ligji sektorial nuk parashikon afate për mbajtjen e të dhënave të aplikantëve të publikuara edhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve. Në rastin e revokimit të licencës, titulli i licencës nuk është më publik dhe të dhënat e titullit nuk janë më publike por sistemi e nxjerr subjektin me statusin “i revokuar”. Të dhënat personale të punonjësve të larguar mbahen në dosjet e tyre të punës deri në momentin që shkëputen marrëdhëniet e punës. Dosja i jepet punonjësit në momentin e largimit nga puna.
- 3) Sa i përket respektimit të nenit 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi i përpunon të dhënat personale në

përputhje me shkronjën a) dhe ç) të këtij neni. Komisioneri vlerëson se përpunimi është në përputhje me kushtet ligjore.

- 4) Kontrolluesi respekton të drejtat e subjekteve të të dhënave personale për akses (neni 12) pasi të dhënat janë publike dhe mund të aksesohen lirisht, për të korrigjuar të dhënat në rast se janë të parregullta (neni 13) dhe të drejtën për tu ankuar (neni 16).

Në kuadër të pikës së dytë të objektit të kontrollit, lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28), Komisionari konstaton se:

- 1) Kontrolluesi i ruan dhe i përpunon në sistem dhe arkivë të dhënat personale të aplikantëve që prej funksionimit të institucionit të QKL-së. Aksesit në sistem është i përcaktuar mbi bazën e profileve të ndara në sportelist (i cili kryen aplikimin), regjistruar (i cili shqyrton dokumentacionin) dhe administrator (i cili ka akses të plotë në regjistrin elektronik. Aksesit në kompjutera dhe sistem është i kufizuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës. Janë marrë të gjitha masat për sigurinë fizike të serverit dhe arkivit.
- 2) Kontrolluesi "Qendra Kombëtare e Licencimit", nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit ligjor.
- 3) Personat që kanë akses në të dhënat personale të aplikantëve (subjekteve të licencuara) dhe ata që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit publik. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, punonjësit e QKL-së, të cilët kanë akses në të dhënat personale të aplikantëve dhe ata që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve, të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Në faqen zyrtare në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (aplikantë ose titullar licence) dhe detyrimet e kontrolluesit (QKL-së) në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
4. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 40 (dyzetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë rekomandim;
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

